



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:128005

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05618891

Ac.nr.4973/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N. I. nga Prishtina, tani me vendbanim në Gjermani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. D., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D.” sh.a me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.. L., për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 497/2015, të datë 16.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa themelta ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “D.” sh.a me seli në Prishtinë, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 497/2015, të datë 16.03.2021 në pikën I dhe II, VËRTETOHET.

II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 497/2015, të datë 16.03.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr. 497/2015, të datë 16.03.2021, ka vendosur:

I. PJESËRISHT MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit N.I. nga Gjermania dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” sh.a në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në automjetin e markës “D. C.”, tipi E CDI, me targë të regjistrimit-MM, si pasojë e aksidentit të trafikut i cili ka ndodh me dt.28.12.2013, t’ia paguaj shumën prej 394.71.00€uro, dhe për shpenzime të udhëtimit t’ia paguajë shumën prej 400.20€, të gjitha këto me kamatë prej 8%, duke iu llogaritur nga data e parashtrimit të kërkesës tek e paditura 03.01.2014 e deri në pagesen definitive.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” sh.a në Prishtinë që paditësit shumat e gjuhuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 615.00 Euro t’ia paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përmbarrimit forcërisht.

III. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N. I. nga Gjermania mbi shumën e gjuhuar në emër të kompensimit të dëmit material për automjetet prej 131.57Euro dhe për shpenzime të udhëtimit shumën prej 133.40 Euro.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjorë, e paditura ka parashtruar ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke i gjuhuar shumat dukshëm më të ulëta, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesën e të paditurës nuk ka paraqitur paditësi, edhe pse i njëjti me kohë është njoftuar me ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, në ankesa, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi N. I. nga Prishtina, tani me vendbanim në Gjermani, me datë 03.03.2015, në Gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D.” sh.a në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, të cilën kërkesë e ka precizuar në shqyrtim kryesorë të datës 16.03.2021, me kërkesë si në procesverbalin e këtij shqyrtimi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqës si dhe administrimit të provave, ka marrë Aktgjykimin e ankimuar C.nr.497/2015 i datës 16.03.2021, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesë padinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: Nga raporti i aksidentit 2013-AR-3703 datë 28.12.2013, rezulton se deri te aksidenti ka ardhur për shkak se ngasësi i veturës “A” i cili ishte duke lëvizura në drejtim të Prishtinë-Podujevë, kur arrin në fshatin B., rruga për B. ka filluar veprimin e kthimit majtas pa u bindur se mund të ndërmer një veprim të tillë dhe pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ndërsa ngasësja e veturës “B” ishte në tejkallim të veturës A, me ç ‘rast si pasojë e këtij aksidentit janë shkaktuar dëme materiale në vetura.

Më tej ka shtuar se: Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit S. B. e datës 26.11.2020, (e cila nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse), prandaj gjykata në tersi ja fali besimin është vërtetuar se deri te aksidentit është shkaktuar si rezultat i lëshimeve të të dy pjesëmarrësve ne komunikacion dhe atë lëshimit e shoferit të veturës A janë: se ka bërë lëvizje/ç ‘kyçje të rrezikshme, duke mos i respektuar rregullat përkthim majtas në vendin ku tejkalimi është i lejuar me sinjalizim (vija të ndërprera)- ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit. Ka pas mundësi që vetura A të perceptoj në largësi ardhjen e automjetit B, dhe është dashtë ti përcjell retrovizorët dhe këndin e vdekur, rruga e drejt, dukshmëria e mirë. Kurse lëshimet e ngasësit të veturës “B” janë: Tejkalimi i rrezikshëm i dy automjeteve njëkohësisht, pra kur mjeti “A” është ngadalësuar përkthim majtas edhe një mjet tjetër pas tij është ngadalësuar deri sa mjeti “B” nuk e ka pritur. Në këtë aksident lëshimet e ngasësit të veturës “A” janë primare me veprim-ç ‘kyçje e pa sigurt nga rruga kryesore në rrugën dytësore, dhe lëshimet e ngasësit “B” janë sekondare tejkalim i rrezikshëm i dy automjeteve njëkohësisht dhe shpejtësi jo –adekuate sipas kushteve të krijuara në komunikacion.

Më tej ka shtuar se: Për të vërtetuar lartësinë e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit, sipas propozimit të autorizuarit të tij, gjykata në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën teknike mbi vlerësimin e dëmit në automjetin nga eksperti i makinerisë S. B., datës 27.11.2021, i cili në bazë të raportit të aksidentit pamjeve të bëra në automjet, shkresave tjera dhe duke e marrë për bazë çmimin e tregut në kohën kur ka ndodhur aksidenti, ka konstatuar se kemi të bëjmë me dëm total dhe vlera e dëmshpërblimit është në shumën prej 1,315.70Euro. Gjykata vlerësoi se mendimi i ekspertit të makinerisë është vlerësim objektiv, real dhe ja fali besimin në tërësi pasi që e njëjta është punuar në mënyrë profesionale dhe është argumentuar në mënyrë mjaft bindëse, e cila nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse.

Më tej ka shtuar se: Në nenin 136 par.1 të LMD-së, përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Neni 159 i LMD-së, par.2 përcakton “*Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre*”. Neni 169 i LMD-së, par.4 përcakton se “*Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyejnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme*”. Neni 176 i LMD-së par.1 përcakton se “*I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar*”.

Më tej ka shtuar se: Me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit për bazat e gjykuara, gjykata pati parasysh edhe faktin e përgjegjësisë së ndarë të këtu palëve ndërgjyqëse dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit kështu duke u nisur nga kjo rrethanë vendosi ta ndajë përgjegjësinë në shkallën% për paditësin-drejtuesin e automjetit “A” dhe ...% për të siguruarën e të paditurës-drejtuesin e automjetit “B”, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, e cila nuk u kundërshtua me prova nga palët ndërgjyqëse, sipas së cilës në këtë aksident lëshimet e ngasësit të veturës “A” respektivisht të paditësit janë primare me veprim- ç’kyçje e pa sigurt nga rruga kryesore në rrugën dytësore, dhe lëshimet e ngasësit të veturës “B” janë sekondare tejkalim i rrezikshëm i dy automjeteve njëkohësisht dhe shpejtësi jo –adekuate sipas kushteve të krijuara në komunikacion. Andaj, mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësinë në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit në automjetin

e tij gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensojë dëmin meqë shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me kompaninë e sigurimit dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësive TPL (sigurimit të detyrueshëm për palët e treta), në pajtim me nenet 136, 159, 169, dhe 176 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (i cili është i aplikueshëm në kohën e shkakimit të aksidentit dhe ushtrimit të padisë në gjykatë).

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 par. 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 452.2, 453 dhe 463 par. 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar palët ankuese me ankesa dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit është në lartësinë prej 30%, gjë që është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit e ekspertit Msc. Inxh. dipl. S.. B. ekspert i licencuar i Komunikacionit, i cili ka konstatuar se, aksidenti i komunikacionit është shkaktuar pasojë e lëshimeve të të dy pjesëmarrësve në komunikacion dhe atë lëshimit e shoferit të veturës A (paditësi) janë: se ka bërë lëvizje/ç 'kyçje të rrezikshme, duke mos i respektuar rregullat përkthim majtas në vendin ku tejkalimi është i lejuar me sinjalizim (vija të ndërprera)- ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit. Ka pas mundësi që vetura A të perceptoj në largësi ardhjen e automjetit B (i siguruari i të paditurës), dhe është dashtë ti përcjell retrovizorët dhe këndin e vdekur, rruga e drejt, dukshmëria e mirë. Kurse lëshimet e ngasësit të veturës "B" janë: Tejkalimi i rrezikshëm i dy automjeteve njëkohësisht, pra kur mjete "A" është ngadalësuar përkthim majtas edhe një mjet tjetër pas tij është ngadalësuar deri sa mjete "B" nuk e ka pritur. Në këtë aksident lëshimet e ngasësit të veturës "A" janë primare me veprim-ç 'kyçje e pa sigurt nga rruga kryesore në rrugën dytësore, dhe lëshimet e ngasësit "B" janë sekondare tejkalim i rrezikshëm i dy automjeteve njëkohësisht dhe shpejtësi jo –adekuate sipas kushteve të krijuara në komunikacion,

fakt ky i vërtetuar nga provat që gjinden në shkresat e lëndës e sidomos ekspertiza e komunikacionit e ekspertit Msc. Inxh. dipl. S. B. ekspert i licencuar i Komunikacionit dhe i Makinerisë, i cili ka konstatuar se paditësi ka përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit e që nuk ka qenë kontestuese edhe nga palët në procedurë. Gjykata e shkallës së parë, me provat e administruara në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar paditësi në këtë aksident i është shkaktuar dëme material në automjetin e tij të tipit M... i tipit E CDI me targa të regjistrimit HA MM....., lartësinë e të cilit dëm e ka vërtetuar përmes ekspertizës së Makinerisë e ekspertit Msc. Inxh. dipl. S. B. ekspert i licencuar i Komunikacionit dhe i Makinerisë, i cili ka përcaktuar vlerën e dëmit në lartësi prej 1,315.70 euro, për të cilën ekspertizë nuk kishin vërejtje. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësi, për shkak të mos funksionimit të automjetit për shkak të aksidentit të datës 28.12.2013, i është shkaktuar dëm material për shkak të udhëtimit për në Republikën e Gjermanisë, përmes linjës Ajrore (Aeroplanë), i cili së bashku me anëtarët e familjes ka paguar bileta udhëtimi në shumë prej 1,334.00 euro, fakt ky i vërtetuar nga fatura FGPIQJ e datës 03.01.2014.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që, për gjykatën e Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi që, me nenin 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se: *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij..”*, Neni 159 i LMD-së, par.2 përcakton *“Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre”*. Neni 169 i LMD-së, par.4 përcakton se *“Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”*. Neni 176 i LMD-së par.1 përcakton se *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë lartësinë e kontributit dhe përgjegjësisë së të siguarit të të paditurës, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit duke e detyruar të paditurën në kompensimin e dëmit paditësit në lartësi të përcaktuar si në aktgjykimin e ankimit pasi që i njëjti dëm është vërtetuar me prova konkrete dhe përmes mendimit të dhënë nga eksperti i komunikacionit e po ashtu edhe atij të Makinerisë.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me atë se në këtë çështje kontestimore janë nxjerrë dy ekspertiza si ajo e komunikacionit e po ashtu edhe ajo e Makinerisë nga i njëjti Ekspert, por të njëjtat pretendime gjykata e Apelit nuk i mori për bazë pasi që shikuar nga shkresat e lëndës, përkatësisht dy ekspertizat e cekura si më lartë konstatohet se eksperti Msc. Inxh. dipl. S..B. ekspert i licencuar i Komunikacionit dhe i Makinerisë, është i licencuar si ekspert i Komunikacionit si dhe ekspert i Makinerisë dhe se në këtë çështje konkrete nuk paraqet pengesë që i njëjti të nxjerrë dy ekspertiza nga këto lami, pasi që i njëjti përmban njohuri profesionale nga dy këto fusha dhe se këto fusha nuk janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, pasi që në ekspertizën e komunikacionit është konstatuar shkaktari i dëmit ndërsa në ekspertizën e Makinerisë është konstatuar lartësia e dëmit në automjetin e paditësit, që nënkupton se nuk mund të kemi ndonjë konflikt apo pengës që i njëjti ekspert që ka licencë të përpilojë të dy këto ekspertiza.

Gjykata e Apelit i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës juridike për dëmin material sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, por të njëjtat pretendime janë të pa bazuara pasi që edhe ky lloje i dëmit bënë pjesë në dëmin material i shkaktuar si pasojë e aksidentit të datës 28.12.2013, kjo për faktin se nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ka qenë duke jetuar dhe punuar në Republikën e Gjermanisë dhe se i njëjti në mungesë të automjetit i cili është aksidentuar, ka qenë i detyruar që të udhëtojë përmes trafikut ajrorë për në Republikën e Gjermanisë dhe i njëjti në bazë të faturës për pagesën e biletave të Aeroplanit vërtetohet se ka udhëtuar me datë 03.01.2014 e që automjeti i tij është rregulluar me datë 26.01.2014, fakte ky i vërtetuar nga fatura nr. 86/14 e datës 25.01.2014, faturë kjo e lëshuar nga N.T.Sh. M.. B., S... M., me seli në Prishtinë. Andaj, nisur nga kjo gjendje e tillë paditësi ka qenë i detyruar që të udhëtoj për në Gjermani dhe si rezultat janë krijuar edhe këto shpenzime, andaj dhe gjykata e shkallës së parë në raport me përgjegjësinë e të paditurës, për këtë pjesë të dëmit ka aprovuar shumën prej 400.00 euro, nga shuma e përgjithshme prej 1,334.00 euro, në lartësi të përgjegjësisë prej 30% të përgjegjësisë së të paditurës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sa i përket vendimit për kumatën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke mos e shqyrtuar pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, pasi që për të njëjtën nuk kishte pretendime ankimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452.2, 453 dhe 463 par. 1 dhe 2 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4973/2021 datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v